



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANË**

---

NR. AKTI 2445

NR. VENDIMI 2314

**V E N D I M**  
**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

**Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, e perbere nga:**

**GJYQTARE – KLORINDA ÇELA**

Asistuar nga sekretare gjyquesore Marjana Xhamallati, **ne Tiranë me date 11.07.2016**, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen penale që i përket:

**KERKUES:** Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, perfaqesuar nga prokurori \*\*\*.

**I PANDEHUR:** \*\*\*, i biri i \*\*\* dhe i \*\*\*, i dtl. \*\*\*, lindur dhe banues ne \*\*\*, me shtetesi dhe kombesi shqiptare, ne mungese, mbrojtur me Prokure te Posaçme nga avokati \*\*\*.

**AKUZUAR:** Per kryerjen e vepres penale “Shkelja e te drejtave te pronesise industriale”, parashikuar nga Neni 149/a pika “c” i K.Penal.

**Gykata, pasi administroi provat në seance gjyquesore, shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuant:**

**Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkoi:**  
--Deklarimin fajtor të të pandehurit \*\*\*, për kryerjen e veprës penale “penale “Shkelja e te drejtave te pronesise industrial”, parashikuar nga Neni 149/a-c i K.Penal, denimin e tij me \*\*\* (\*\*\* ) leke gjobë.

--Ne zbatim te Nenit 406/1 te K.Pr.Penale, te pandehurit \*\*\*, i ulet 1/3 e denimit  
dhe perfundimisht denohet me \*\*\* (\*\*\*) leke gjobë.

--Shpenzimet proceduriale ti ngarkohen te pandehurit.

--Mbrojtesi i te pandehurit Av. \*\*\* kerkoi:

--Deklarimin e pafajshem te te pandehurit \*\*\*, pasi fakti object gjykimi nuk  
perben veper penale.

--Heqjen e sekuestros te sendeve te sekuestruara sipas procesverbaleve te  
dates \*\*\*, mbajtur nga oficeri i policise gjyqesore \*\*\* dhe \*\*\*.

## V Ë R E N

**Se, Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane, ka paraqitur per gjykim proçedimin  
penal        Nr. \*\*\* te vitit 2015, ne ngarkim te te pandehurit \*\*\*, akuzuar per  
kryerjen e vepres penale te "Shkelja e te drejtave te pronesise industriale",  
parashikuar nga Neni 149/a/pika c i K.Penal.**

Gjykata konkludoi se, ka juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe  
kompetencën tokësore, per te gjykuar kete proçedim penal, bazuar ne Nenet  
69, 74, 76 K.Pr.Penale.

Çeshtja penale e paraqitur per gjykim ne ngarkim te te pandehurit \*\*\* do të  
gjykohet nga trupa gjyqesore e perbere nga një gjyqtar, bazuar ne Nenin 13 të  
K.Pr.Penale, kjo per faktin se vepra penale per te cilin akuzohet I pandehuri,  
eshte kundervajtje penale dhe parashikon denim me gjobe ose një vit burgim.

Në kerkesat paraprake ne dobi te gjykimit, ipandehuri \*\*\* nepermjet mbrojtesit  
te tij, nepermjet njohjes me te drejtat dhe detyrimet proçedurale, kerkoi te  
gjykohej me gjykim te shkurtuar, me pretendimin se çeshtja mund te zgjidhej  
ne gjendjen qe jane aktet.

Lidhur me kete kerkim te mbrojtjes, gjykata pasi degjoi edhe mendimin e  
prokurorit te seances gjyqesore, i cili u shpreh për pranim të kësaj kërkese,  
bazuar ne Nenin 404 të K.Pr.Penale, Vendimin Unifikues Nr.2 datë 29.01.2003 të  
Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe Vendimin Nr.4 dhe 24 të

**vitit 2012 të Gjykatës Kushtetuese, me vendim te ndermjetem, vendosi te pranoje gjykimin e shkurtuar, pasi konkludoi se çeshtja zgjidhet në gjendjen që janë aktet e procedimit penal te paraqitura nga organi i akuzes.**

**Ne kete rast, gjykata shqyrtoi si prova, aktet e procedimit penal te sipercituar, te cilat i bashkangjiten fashikullit te gjykimit.**

**Nga diskutimi gjyqesor i fakteve dhe rrethanave te çeshtjes, rezultoi e provuar se:**

**I pandehuri \*\*\* eshte banor ne adresen e sipercituar.**

**Ne daten 07.10.2015 nga ana e sherbimeve te strukturave te policise kunder krimtit ekonomik prane Drejtorisë se Policise se Qarkut Tirane eshte ushtruar kontroll prane dy dyqaneve : “\*\*\*” .. e ndodhur ne Rrugen "Sarni Frasherri" dhe dyqanin “\*\*\*” qe ndodhet brenda qendres tregtare \*\*\*, aktivitetave private keto qe sherbejne per tregtimin e rnatrave industrial, kryesisht veshembathje te importuara nga vende te njeriushme. te cilat jane ne pronesi te te pandehurit \*\*\*. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e strukturave te policise jane gjetur e sekuestruar mallra, qe mbrohen nga rmarkat tregtare.**

**Konkretisht ne dyqanin “\*\*\*”, jane sekuestruar me cilesine e proves materiale nje sasi e konsiderueshme kepuce- atlete te markave “NIKE” dhe “ARMANI” si dhe veshje te jashtme te markave” .. “ARMANI” “ADIDAS” , “LEVIS”, etj...**

**Ndersa ne dyqanin “\*\*\*” jane gjetur e sekuestruar me cilesine e proves material nje sasi e konsiderueshme veshje te jashtme te markave “ ARMANI” “ADIDAS”, “LEVIS”. “LACOSTE”..etj.**

**Ndersa ne dyqanin “\*\*\*”, jane gjetur e sekuestruar me cilesine e proves materiale, nje sasi e konsiderueshme veshje te jashtme, te markave “ARMAN!”, “ADIDAS”, “CALVIN CLEIN ”, “ LACOSTE ”, etj.**

**Sipas pretendirnit te organit te akuzes, duke qene se marrat e mesiperme mbrohen nga markat tregtare mjaft te njohura, mungesa e dokumentacionit per blerjen e tyre ne burim apo ofrimi per shitje pa pelqimin e pronarit te markave ne fjalë, perben shkelje te normave te parashikuara ne Nenit 140, 141, 142, 156, te ligjit Nr. 9947 te dates 07.07.2008 "Per pronesine industriale". Te dhena keto te pasqyruara ne procesverbalet e kontrollit dhe te sekuestrit te provave materiale te dates 07.10.2015, te kqyrjes dhe marrjes se dokumenteve. Pika 4 e Nenit 14 te ketij ligji, jep kuptimin e termit**

"Licencim", i cili eshte dhenia e licences, nepermjet se ciles pronari i regjistrimit te njerit prej objekteve te pronesise industriale (licencuesi) ,lejon palen tjeter (te licencuarin), te kryeje cdo akt apo veprim te permendur, perkatesisht, ne Nenet 46, 47, 129, 140 dhe 163.

Gjate hetimeve paraprake ne marrjen ne pyetje te pandehurit \*\*\* ka deklaruar se mallrat e sekuestruara jane blere prej tij nga shoqeria tregtare “\*\*\*” e cila zhvillon aktivitet tregtar brenda territorit te Shqiperise. Perfaquesuesit e kesaj shoqerie tregtare nuk kane pranuar se i pandehuri eshte furnizuar prej shoqerise se tyre me mallrat e markave te mbrojtura.

Nga gjithe te dhenat e parashtruara me siper, sipas organit te akuzes, vertetohet plotesisht se nga i pandehuri \*\*\* jane konsumuar plotesisht elementet e vepres penale "Shkelja e te drejtave te pronesise industriale" parashikuar nga Neni 149/a/c i Kodit Penal.

Ne lidhje me hetimin e kesaj ceshtje penale eshte pyetur si person qe ka dijeni per vepren penale shtetasi \*\*\* (menaxher shitjesh prane kompanise \*\*\*), i cili ne daten 21.01.2016 ne ligjrate te drejte ka deklaruar se: Une kam gjeneralitetet e mesiperme dhe aktualisht punoj si menaxher shitjesh prane kompanise “\*\*\*” qe prej rreth dhjete vjetesh ku administrator eshte daja im shtetasi \*\*\*, i cili eshte me banim ne Turqi prej disa vitesh dhe jeton atje.

**Pyetje:** Mund te me shpjegoni se me cfare aktiviteti merret shoqeria juaj dhe a eshte e rregjistruar ne Q.K.R? **Pergjigje.** Shoqeria “\*\*\*: me administrator shtetasin \*\*\* merret me aktivitetin dhe importin e veshmbathjeve te ndryshme nga shteti i Turqise, ku per kete fakt jemi te rregjistruar ne Q.K.R.

Shoqeria jone operon ne treg duke marre porosi per artikuj te ndryshem veshmbathje nga tregetare te ndryshem si dhe duke pare kerkesen e tregut per mall. Pasi marrim porosine nga klienti ne e gjejme mallin ne Turqi vete ose me sygjerimin e klientit dhe bejme blerjen e mallit. Me pas me ane te kamioneve te marre me qera bejme trasportimin e ketij malli nga Turqia per ne Shqiperi, duke bere dhe zhdoganimin e mallit ne dogane sipas rregullave doganore , ku me pas bejme depozitimin e mallit ne magazinen tone ne Tirane. Pasi bejme hyrjen e mallit ne magazine bejme shitjen me fature tatimore tek klientet qe kane bere porosi mallin si dhe te kliente te ndryshem qe jane te interesuar per mallin qe ne tregetojme.

**Pyetje:** Cfare marredheniesh keni ju si firme me shtetasin \*\*\* qe eshte

**administrator i firmes \*\*\*,a e keni furnizuar me mall kete firme ,nese po me cfare mallrash konkretisht ?** **Pergjigje:** Firma jone bashkpunon me shume firma ne tregun shqiptar qe jane te interesuara per blerjen e mallit tone dhe nje nder keto firma eshte dhe firma \*\*\* me administrator shtetasin \*\*\*. Ne kemi bere disa shitje ne kete firme duke i deklaruar me fature tatimore per artikuj te ndryshem qe per momentin nuk me kujtohen.

**Pyetje:** Deklarues a mund te na thoni nese firma juaj tregeton artikuj veshmbathje te markave te ndryshme si “Adidas ,Armani,Diezel,Lewis ,Nike” te cilat jane marka te falsifikuara ,nese po si e beni zhdoganimin e ketyre artikujve ne dogane?

**Pergjigje:** Firma ku une punoj nuk ka importuar asnjehera keto lloj artikujsh qe me permendet ,por vetem artikuj te firmave turke.Gjithmone kur malli i firmes eshte bere zhdoganimi eshte kontrolluar nga autoritetet doganore dhe nuk eshte konstatuar asnje rast i tille. Dua te shtoj se nga firma jone nuk i jane shitur artikuj te markave te mesiperme te fallsifikuara firmes \*\*\* me administrator shtetasin \*\*\* ,por artikuj te firmave Turke.

**Pyetje.** Deklarues a keni ju gjendje mall ne magazinat e firmes tuaj te artikujve te veshmbathjes dhe a dispononi fatura per kete mall? **Pergjigje.** Ne kemi gjendje ne magazine mall te artikujve te veshmbathjes te cilat jane te gjitha te deklaruara dhe te zhdoganuara dhe nuk kemi asnje artikull marke te fallsifikuar.

--Deklarimet e personit ndaj te cilit zhvillohen hetime \*\*\* , data 07. 10.2015

**Pyetje:** Deklarues gjate kontrollit te ushtruar ne dyqanin tuaj \*\*\* dhe dyqanit \*\*\* qe ndodhet prane \*\*\* jane gjetur dhe sekuestruar nje sasi veshjesh si xhinse,bluza,xhakovente dhe atlete te markave

**Adidas,Armani,Nike,Diezel,Levis,Antonio Murati** te cilat dyshohen se jane marka te fallsifikuara.cmund te na thoni ne lidhje me kete fakt dhe ku e keni blere ju kete mall ?

**Pergjigje:** Une kam rreth dhjete vjet qe ushtroj kete aktivitet dhe kam dyqan \*\*\* ne Rr \*\*\* dhe \*\*\* prane \*\*\*.Ne keto dyqane tregetoj shumellojshmeri mallrash,nder to dhe veshje me markat e lartpermendura.Mallrat zakonisht i kam marre jasht vendit ne Itali,Turqi sipas rregullave duke bere dhe procedurat doganore. Ne lidhje me mallrat marke Adidas,Armani,Diezel,Levis,Nike dua te theksoj se keto veshje i kam blere tek firma \*\*\* Sh.p.k. tek ish parku

autobuzave. Menyra se si e kam blere kete mall ne kete firme ka qene duke e pare ne magazine dhe e kam porositur duke e blere me fature tatimore te cilen e kam likujduar me banke. Ne kete firme kam blere pantollona xhins te markes Armani dhe Diesel,bluza te markave Armani,dhe kepuce te markave Nike dhe Armani.Ne fature tatimore keto mallra jane shenuar si pantollona xhmse ,kepuce,bluza pa percaktuar marken e tyre. Per kete mall disponoj dhe dokumentacionin e faturave tatimore te blerjes se mallit ne kete firme. Ne lidhje me kete fakt dua te sqaroj se nuk kam dijeni se keto mallra me markat e mesiperme nuk duheshin te tregtoheshin dhe perfaquesues te kesaj firme me kane sigruuar se nuk kishte asnje problem.

--Deklarimet e personit ndaj te cilit zhvillohen hetime \*\*\*, data 10. 02.2016.

**Pyetje:** Deklarues gjate kontrollit te ushtruar ne daten 06.10.2015 ne dyqanin tuaj \*\*\* qe ndodhet ne Rr \*\*\* jane gjetur dhe sekuestruar nje sasi veshjesh si xhinse,bluza,dhe atlete te markave adidas.Armani,Nike,Diesel,Levis,Antonio Mura ti te cilat dyshohen se jane marka te fallsifikuara.cmur d te na thoni ne lidhje me kete fakt dhe ku e keni blere ju kete mall ?

**Pergjigje:** Sic kam thene dhe ne deklarimin e dates 06.10.2015, une kam rreth dhjete vjet qe ushtroj kete aktivitet dhe ne dyqan tregetoj shumellojshmeri mallrash.nder to dhe veshje me markat e lartpermendura. Mallrat zakonisht i kam marre jashte vendit ne Itali,Turqi sipas rregullave duke bere dhe procedurat doganore.

Po keshtu kam blere mall dhe ne firma shqiptare si “\*\*\*”, “\*\*\*” \*\*\* Sh.p.k dhe disa te tjera. Pyetje. Deklarues ju keni thene se, mallrat marke Adidas,Armani,Diesel,Levis,Nike i keni blere te firma “\*\*\*” Sh.p.k. tek ish parku autobuzave,a eshte i vertete ky fakt.

**Pergjigje:** Sic theshte dhe me lart une kam blere mall ne kete firme,por jemi fokusuar me shume te cilesia dhe te prerja e mallit dhe nuk e mbaj mend me saktesi se te kush firme i kam blere apo i kam sjelle vete nga jashte keto mallra qe jane marka, pasi kete mall kam patur shume kohe qe e kam gjendje ne dyqan dhe nuk me eshte shitur. Ne lidhje me kete fakt dua te sqaroj se, nuk kam dijeni se keto mallra me markat e mesiperme nuk duheshin te tregtoheshin dhe se jane marka te mbrojtura.

Gjithashtu edhe kur eshte pyetur si I pandehur I eshte permbajtur deklarimeve qe ka dhene si me siper cituam.

**Sa më sipër organi i akuzes, ndaj te pandehurit \*\*\* ka kerkuar deklarimin fajtor dhe denimin si ne pjesen hyrese te vendimit.**

--Mbrojtja e te pandehurit \*\*\* ka kerkuar dhe parashtruar perfundimisht: I pandehuri ka mbi 15 vjet qe ushtron aktivitetin ne fushen e veshjeve dhe kepuceve duke u furnizuar ne disa subjekte brenda dhe jashte vendit te licensuara, per te cilat disponon fatura dhe dokumentacionet e eksporteve duke zbatuar ligjet ne fuqi si ne Republiken e Shqiperise dhe Komunitetit European, prova te cilat jane depozituar gjate fazes se hetimeve paraprake. ku jane pyetur rreth rrethanave te faktit objekt gjykimi, si dhe jane administruar dhe ndodhen ne fashikullin e gjykimit.

Per mallrat qe akuzohet i pandehuri, gjate pyetjes ne prokurori ka deklaruar se eshte fumizuar nga subjektet brenda vendit te cilat tregtojne mallra industriale me shumice, ku nder keto mallra produktet kane qene te markave nga me te ndryshme si ARMANI.. ADIDAS.. ·'LEVIS·· ... LACOSTE ... NIKE", ku ofertat e tyre kane qene te leverdishrne si dhe jane shoqeruar me dokumentacionin perkates, te shoqeruar me fature tatimore te rregullt (fatura te cilat ndodhen dhe ne fashukullin e gjykimit).

I pandehuri nuk ka qene ne dijeni qe keto mallra kane qene te jashtelijshme duke menduar se kane kaluar nepermjet doganes konform te gjitha procedurave doganore dhe aq me teper qe subjekti “ \*\*\*” i ka shitur me te gjithe dokumentacionin e nevojshem ligjor te subjektet e shitjeve me pakice sic eshte ne rastin konkret, par nje tregtar i shitjeve me pakice.

Nga ana e organit te Prokurorise nuk eshte bere asnje hetim ne lidhje me subjektin tregtar furnizues ” \*\*\*” qe te provohet fakti se ne magazinat e tyre nuk ka asnje mall te ketyre markave tregtare qe prokuria i pretendon te paligjshrn, por organi i akuzes eshte mjaftuar vetem me marrjen ne pyetje te perfaquesuesve te kesaj shogerie tregtare te cilet norrnalisht nuk pritej te ndodhе ndryshe e kane mohuar.

Atehere si eshte e mundur qe versioni i deklaruar nga subjekti “ \*\*\*” ka qene i besueshem ku nderkohe nuk eshte ushtruar asnje kontroll nga ana e Prokurorise prane magazinave te saj per te hetuar per kete fakt (sic eshte bere ne rastin konkret) por ngarkon te pandehurin me perjegjesi penale.

Ku theksoj se ky subjekt tregtar qe i ka bere oferta per mallrat me markat e mesiperrne te pretenduara nga Prokuroria si te paligjshrn, ushtron aktivitetin

normal duke vazhduar ti beje oferta dhe duke patur gjendje mallrash ne magazinat e tyre sasi shume here me te madhe se sasia e mallrave per te cilien akuzohet i pandehuri.

Por meqenese pretendohet nga subjekti tregtar “\*\*\*” se ajo nuk i ka shitur mallrat e markave te lartpermendura pse nuk u hetua se cfare mallrash dhe cfare marke i ka shitur te pandehurit? Pasi ne faturat tatimore te leshuara nga ky subjekt nuk percaktohet as marka dhe as logo e mallrave por thjesht citohet lloji, sasia dhe cmimi, fatura keto te administruara gjate hetimit te kesaj ceshtje, qe ndodhen ne fashikullin hetimor.

Por, theksoj se per te njejtin subjekt tregtar “\*\*\*” dhe per te njejtin fakt, subjekti i sipercituar ka furnizuar edhe subjekte te tjera si ne rastin tone, ku nga ana e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur “Mosfillimi i procedimit penal”, pasi nuk jane gjetur elemente te vepres penale per subjekte te shitjes me pakice te mallrave te furnizuar prej saj. Raste analoge ka edhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Durres dhe Tirane te cilat jane regjistruar dhe proceduar per vepra penale te parashikuara nga Neni 149/a i Kodit Penal, ku eshte vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Prokuroria e ka mbeshtetur akuzen ne faktin e gjetjes se ketyre mallrave ne dyqanin e te pandehurit, edhe pse ai disponon faturat tatimore per te gjithe mallin qe gjendet ne dyqanin e tij. Por organi i akuzes pa kryer veprime te tjera hetimore ku te kontrollonte magazinat ku ky subjekt furnizohej dhe te verifikonte nese gjendej mall me marka te tilla, asaj i eshte dukur me bindese te akuzonte te pandehurin, veteri sepse ne faturat tatimore nuk kishte percaktim te emrit te markave.

Por duar te theksoj se I pandehuri eshte furnizuar edhe nga subjekte te tjere si: \*\*\* Shpk. \*\*\*Shpk, \*\*\*Shpk, \*\*\* Shpk. \*\*\*Shpk. \*\*\*, ku keto subjekte operojne me firmat e lartpermendura, por me te gjitha keto subjekte tregtare ku une kam blere mallrat e ndryshem jane leshuar fatura tatimore konform ligjit, por pa specifikuar marken. Edhe ne furnizimet qe kane here ne shtetin Italian per mallrat e ndryshme, ka disponuar fatura tatimore ku jane deklaruar edhe ne dogane por pa u specifikuar marka apo logo e tyre, thjeshte lloji i produktit, sasia dhc cmimi. (Fatura tatimore italiane te depozituara ne fashikullin e hetimit).

Nga ana e organit te akuzes pretendohet se ne rastin konkret jane shkelur

norma te parashikuara ne Nenet 140, 141, 142, 156, te Ligjit Nr. 994 7 date 07.07.2008 " Per Pronesine Industriale", dispozita keto qe nuk gjejne zbatim ne rastin objekt gjykimi. Te gjitha keto nene dhe baza ligjore per te mbeshtetur fajesine, nuk kane te bejne me faktin objekt gjykimi.

Nese I referohemi Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" konkretisht Neni 36 , sic percakton kjo dispozite, qe te kemi veper penale kerkon qe subjekti i vepres penale te jete ne dijeni se produkti, malli apo sherbimi qe ofron per shitje jo vetem qe eshte e tille qe mbrobet nga nje patente, dizenjo industriale apo marke tregtare sikurse ne rastin konkret, por gjithashtu te kete dijeni se nuk eshte dhene pelqimi nga pronari per shitjen e tyre. Ne rastin konkret ne shqyrtim, nuk provohet qe i pandehuri \*\*\* te kete dijeni se importimi i ketyre mallrave nga firma tregtuese (qe kane leshuar fatura tatimore) qe tashme i shet ne dyqanin e tij, eshte bere ose jo pa pelqimin e pronarit te tyre.

Kjo pasi, siç provohet, keto mallra jane te blera ne nje shoqeri tregtare qe operon ne tregun shqiptar me shumice. Pra sic provohet , I pandehuri eshte person fizik qe ushtron tregtim me pakice dhe malli qe tregon eshte blere kundrejt faturave perkatese tatimore tek nje person juridik qe ushtron aktitivitet tregtar te licensuar. Per keto arsyet bazuar ne Nenin 388 germa "b" te Kodit te Procedures Penale, kerkojme :-- Te deklarohet I pafajshem i pandehuri \*\*\*, pasi fakti objekt gjykimi nuk perben veper penale si dhe heqjen e sekuestros te sendeve te sekuestruara sipas procesverbaleve te date

**07.10.2015.**

**Gjykata, pasi ka administruar ne teresi fashikullin e prokurorise, me Nr. \*\*\* procedimi, te vitit 2015, e cila me pas u be pjese e fashikullit te gjykimit, konkludoi se I pandehuri: \*\*\* nuk ka konsumuar elementët e vepres penale te " Shkelja e te drejtave te pronesise industriale", parashikuar nga Neni 149/a/pika c i K.Penal , ku duhet te deklarohet I pafajshem .**

**Këto fakte per cilat akuzohej I pandehuri \*\*\*, sipas organit te akuzes, por qe u konkludua ne pafajesi nga gjykata, provohen plotësisht me një serë provash shkresore, te cilat u çmuan nga ana e gjykates ne harmoni me njera, sipas Neneve 151 dhe 152 te K.PR.Penale, te cilat i perkasin ketij procedimi penal,**

**ku po permendim:**

- Procesverbale te kontrollit te vendeve te dates **06.10.2015**.
- Procesverbale te sekuestrimit te sendeve prove materiale te dates **07.10.2015**.
- Procesverbale te lenies ne ruajtje te sendeve prone materiale te dates **07.10.2016**.
- Procesverbale per marrjen e dokumenteve te dates **07.10.2015**.
- Procesverbal deklarimi i shtetasit \*\*\* i dates **21.01.2016**.
- Procesverbali per njojen e te pandehurit me aktet i te pandehures \*\*\* i dates **20.04.2016**. --Vertetim elektronik i gjendjes gjyqesore i te pandehurit \*\*\*

**Neni 149/a/pika c: "Shkelja e te drejtave te pronesise industriale", parashikuar nga Neni 149/a/pika c i K.Penal, parashikon se :**

**"Prodhimi, shperndarja, mbajtja per qellime tregtimi, shitja, ofrimi per shitje, furnizimi, shperndarja, eksportimi ose importimi per keto qellime i:**

- a) produktit ose procesit te mbrojtur nga nje patente, pa pelqimin e pronarit te patentes;**
- b) produktit qe mbrohet nga nje dizenjo industriale, pa pelqimin e pronarit te dizenjos industriale;**
- c) mallrave ose sherbimeve qe mbrohen nga nje marke tregtare, pa pelqimin e pronarit te markes tregtare....., perben kundervajtje penale dhe denohet me gjobe ose me burgim gjer ne nje vit.**

**Objekti i vepres penale te parashikuar nga Neni 149/a/pika c i K.Penal.**

Duhet te jene veprimet e kunderligjshme te kryera nga i pandehuri \*\*\* , qe te kene cenuar marredheniet juridike te vendosura me ligj per mbrojtjen e te drejtes se pronesise industriale, te markes tregtare dhe te drejtave pasurore qe rrjedhin nga perdorimi i tyre te personave fizike, apo juridike nga veprimet kriminale te mbrojtuara nga legjislacioni yne penal.

Nga ana objektive kjo vepre penale duhet te konsumohet ne kryerjen e veprimtarise se paligjshme te shperndarjes se mallrave te rreme, me karakteristika te ngjashme me produktin origjinial qe mbrohet nga nje "marke tregtare", pa pelqimin e pronarit te markes tregtare.

Duhet qe veprimtaria e paligjshme e te pandehurit te jetë kryer ne shkelje te dispozitave referuese te Ligjit specifik Nr.9947, date 07/07/2008 "Per pronesine

industriale”, te aplikueshem ne rastin objekt shqyrtimi, qe disiplinon dhe rregullon sistemin e dhenies dhe te mbrojtjes se te drejtave te pronesise industriale ku perfshihen edhe markat tregtare (Neni 1 i ketij Ligji).

Pikerisht ne Nenet 140 e vijues te Ligjit te sipercituar, percaktohen shprehimisht shenjat qe perbejne “marke”, menyra e rregjistrimit te tyre dhe fitimi i te drejtes per marke, procedura e rregjistrimit te markes, si dhe te drejtat qe rrjedhin nga rregjistrimi i saj.

Sipas Nenit 156 te ketij Ligji: “Pronari i markes se rregjistruar, gezon te drejten ekskluzive te perdorimit te markes, ne perputhje me te drejtat e parashikuara ne kete ligj.

Pronari i markes se rregjistruar gezon te drejten te ndaloje personat e trete te perdorin gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a. nje shenje qe eshte e njeje me marken, per mallra dhe sherbime, qe jane te njejta me ato, per te cilat eshte rregjistruar marka, etj.

Nga ana subjektive, vepra penale duhet te kryhet me dashje direkte dhe me qellimin e posaçem per te nxjerre perfitim material nepermjet shitjes se produkteve te falsifikuar.

Subjekte te kryerjes se kesaj vepre penale eshte subject I per gjithhem dhe te kete mbushur moshen per pergjegjesi penale.

--Pra ne gjykim rezultoi se, ne daten 07.10.2015 nga ana e sherbimeve te strukturave te policise kunder krimtit ekonomik prane Drejtorese se Policise se Qarkut Tirane eshte ushtruar kontroll prane dy dyqaneve : “\*\*\*\*” .. e ndodhur ne Rrugen “\*\*\*\*” dhe dyqanin “\*\*\*\*” qe ndodhet brenda qendres tregtare \*\*, aktiviteteve private keto qe sherbejne per tregtimin e rnalavrave industrial, kryesisht veshembathje te importuara nga vende te ndryshme te cilat jane ne pronesi te te pandehurit \*\*. Nga kontrolli i ushtruar nga ana e strukturave te policise jane gjetur e sekuestruar mallra, qe mbrohen nga markat tregtare.

Konkretisht ne dyqanin “\*\*\*\*”, jane sekuestruar me cilesine e proves materiale nje sasi e konsiderueshme kepuce- atlete te markave “NIKE” dhe “ARMANI” si dhe veshje te jashtme te markave” .. “ARMANI” “ADIDAS”, “LEVIS”, etjj...

Ndersa ne dyqanin “\*\*\*\*” jane gjetur e sekuestruar me cilesine e proves material nje sasi e konsiderueshme veshje te jashtme te markave “ ARMANI” “ADIDAS”, “LEVIS”. “LACOSTE”... etj. Ndersa ne dyqanin “\*\*\* ”, Jane gjetur e sekuestruar me cilesine e proves materiale, nje sasi e konsiderueshme veshje

te jashtme, te markave "ARMAN!", "ADIDAS", "CALVIN CLEIN ", " LACOSTE ", etj.

Sipas pretendirnit te organit te akuzes, duke gene se mallrat e mesiperme mbrohen nga markat tregtare mjaft te njohura, mungesa e dokumentacionit per blerjen e tyre ne burim apo ofrimi per shitje pa pelqimin e pronarit te markave ne fjale, perben shkelje te normave te parashikuara ne Nenet 140, 141, 142, 156, te ligjit Nr. 9947 te dates 07.07.2008 "Per pronesine industriale".

Gjate hetimeve paraprake ne marrjen ne pyetje te pandehurit \*\*\* ka dekluaruar se mallrat e sekuestruara jane blere prej tij nga shoqeria tregtare \*\*\*\* e cila zhvillon aktivitet tregtar brenda territorit te Shqiperise. Perfaquesuesit e kesaj shoqerie tregtare nuk kane pranuar se i pandehuri eshte furnizuar prej shoqerise se tyre me mallrat e markave te mbrojtura.

Neni 140, I Ligjit Nr. 994 7 date 07.07.2008 " Per Pronesine Industriale" parashikon se:

**Shenjat qe perbejne marke**

1-- Cdo shenje ose kombinim shenjash. qe paraqitet grafikisht dhe qe sherben per te dalluar mallrat apo sherbimet e nje personi fizik ose juridik, nga ato te nje personi tjeter fizik ose juridik. eshte marke qe perfaqeson ato mallra ose sherbime, me kusht qe te perm bushen kerkesat e neneve 141 deri ne 143 te ketij ligji (ne vijim do te quhet "marke ').

2-- Perbejne marka shenjat e me poshtme: a) fjalet, perfshire emrat personale. shkronjat, numrat, shkurtimet: h) shenjat figurative. perfshire vizatimet; c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre. f) kombinimet e ngjyrave e te drite -hijeve. si dhe ngjyrat ne vetvete: d) cdo kombinim i shenjave, te pretendura nga shkronjat "a" deri ne "c " te kesaj pike.

3-- Markat regjistrohen vetem nese ato mund te paraqiten grafikisht Kjo lidhet vecanerisht me lloje te vecanta markash, si zeri dhe sinjalat e drites, por jo vetem me keto.

Neni 141 parashikon se: Karakteri dallies -- Nje shenje ka karakteri dallues. nese nepermjet saj perdoruesi i zakonshem dallon nje numer mallrash dhe sherbimesh specifike, nga nje tjeter numer mallrash dhe sherbimesh, te njejta me te parat, e lidhur perkatesisht me origjinën tregtare te tyre. Karakteri

dallues i nje shenje vleresohet ne lidhje te ngushte me mallrat dhe sherbimet. te cilat shenja ka per qellitn t'i dalloje.

Neni 142 parashikon se: Refuzimi per shkaqe absolute 1--Nje shenje nuk: regjistrohet si marke nese: a) nuk ka karakter dallues; b) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qe sherbejne ne treg per te treguar llojin, cilesine, sasine, qellimin, vleren, origjinjen gjeografike ose kohen e prodhimit te mallrave apo te kryerjes se sherbimeve ose per te treguar karakteristika te tjera te mallrave apo te sherbimeve; c) perbehet ekskluzivisht nga elemente ose tregues, qejane bere te zakonshem ne gjuhen e perditshme apo qe jane kthyer ne praktika tregtare; d;) perbehet nga forma ose vija, te imponuara nga vete natyra e mallrave apo e sherbimeve dhe/ose forma apo linja thelbesore, per te perm bushur nje rezultat teknik; d) perbehet nga forma qe u japid mallrave nje vlere thelbesore; dh) perbehet nga elemente, qe cenojne interesin puhlik ose qe bien ne kundershtiin me vlerat morale apo rendin publik; e) perbehet nga elemente, qe kane prirje te corientoine publikun per natyren, cilesine, origjinjen gjeografike le mallrave dhe/ose sherbimeve, qe ato kane per qellim te dallojne; e) perbehet nga tregues gjeografike per vererat ose pijet alkoolike qe nuk e kane origjinjen gjeografike nga vendet, qe tregohen ne keta tregues, edhe nese tregohet origjina e vertete e produkteve ose treguesit gjeografike jane perkthyer apo shoqeruar me shprehje te tilla. si "lloji .. "tipi .. "stili .. "imitimi .. ose shprehje ti! ngjashme; .f) perbehet nga emra, portrete, pseudonitne personale, le mirenjohura ne Republiken e Shqiperise. per perdorimin e te cilave nuk eshte dhene autorizim nga vete personi ose pasardhesi i tij: g) perbehet nga emra shtetesh (te plote ose te shkurtuar); ii) emblema shteterore, medalje, urdhra nderi. iii) vula dhe shenja zyrtare te miratuara nga vendi; iv) emblemat e organizatave te njoitura nderkombetare ose shkurtimet e tyre; v) simbolet fetare; vi) flamujt kombetare, gj) perbehet nga elemente qe bien ne kundershtim me nenin 6 te Konventes se Parisit.

--2. Nje shenje nuk perjashtohet nga regjistrimi si marke, ne perputhje me shkronjat "a .. "b " e "c " te pikes I te ketij neni, ne qofte se marka, objekt shqyrtimi, kafituar karakter dallues ne procesin e perdorimit perpara dates se aplikimit.

Neni 156 parashikon se: Te drejtat qe rrjedhin nga regjistrimi --Pronari i

markes se regjistruar gezon te drejten ekskluzive te perdonimit te markes ne perputhje me te drejtat e parashikuara ne kete ligj. Pronari i markes se regjistruar gezon te drejten te ndaloje personat e trete te perdonin, gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) nje shenje, qe eshte e njeje me marken, per mallra dhe sherbime, qe jane te njejtë me ato, per te cilat eshte regjistruar marka; b) nje shenje, qe eshte e njeje ose e ngjashme me marken apo qe, per shkak te njellojshmerise apo ngjashmerise te mallrave ose sherbimeve, per te cilat perdoret shenja, me mallrat apo sherbimet, qe mbulohen nga marka e regjistruar, mund te shkaktojne konfuzion te publiku, ku perfshihet edhe mundesa e bashkelidhjes se shenjes me marken tregtare: c) nje shenje te njejtë ose te ngjashme per mallra apo sherbime, edhe kur keto nuk jane as te njejtë e as identike me ato, per te cilat eshte regjistruar marka, ne rast se marka ka reputacion ne Republiken e Shqiperise dhe nga perdonimi i shenjes, pa shkak te arsyeshem, realizohet nje perfitim i padrejte ose demtohet natyra dalluese apo emri i mire i markes.

3--Ne perputhje me piken 2 te ketij neni, gjithashtu, ndalohet: a) vendosja e shenjes te mallrat ose ambalazhet e tyre: b) hedhja e mallrave ne treg, ofrimi i tyre per shitje, duke perdonur kete shenje, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave per keto qellime; c) ofrimi i sherbimeve. duke perdonur kete shenje; d;) importimi ose eksportimi i mallrave, duke perdonur kete shenje; d) perdonimi i shenjes ne veprimtarine tregtare, ne reklamime ose publicitete.

4--Te drejtat, qe i njihen pronarit te markes se regjistruar sipas ketij neni i njihen edhe pronarit te markes se mirenjohur ne Republiken e Shqiperise, ne perputhje me percaktimin e shkronjes c, te pikes 5 te Nenit 143 te ketij ligji. Ne rastin konkret, I pandehuri ka mbi 15 vjet qe ushtron aktivitetin ne fushen e veshjeve dhe kepuceve duke u furnizuar ne disa subjekte brenda dhe jashte vendit te licensuara, per te cilat disponon fatura dhe dokumentacionet e eksporteve duke zbatuar ligjet ne fuqi si ne Republiken e Shqiperise dhe Komunitetit European, prova te cilat jane depozituar gjate fazes se hetimeve paraprake. ku jane pyetur rreth rrethanave te faktit objekt gjykimi, si dhe jane administruar dhe ndodhen ne fashikullin e gjykimit.

Per mallrat qe akuzohet i pandehuri, gjate pyetjes ne prokurori ka dekluaruar se eshte fumizuar nga subjektet brenda vendit te cilat tregtojne mallra industriale me shumice, ku nder keto mallra produktet kane qene te markave nga me te

ndryshme si ARMANI .. ADIDAS .. 'LEVIS .. LACOSTE ... NIKE", ku ofertat e tyre kane qene te leverdisshrne si dhe jane shoqeruar me dokumentacionin perkates, te shoqeruar me fature tatile te rregullt (fatura te cilat ndodhen dhe ne fashukullin e gjykimit).

I pandehuri nuk ka qene ne dijeni qe keto mallra kane qene te jashteligjshme duke menduar se kane kaluar nepermjet doganes konform te gjitha procedurave doganore dhe aq me teper qe subjekti " \*\*\*" i ka shitur me te gjithe dokumentacionin e nevojshem ligjor te subjektet e shitjeve me pakice sic eshte ne rastin konkret, par nje tregtar i shitjeve me pakice.

Nga ana e organit te Prokurorise nuk eshte bere asnje hetim ne lidhje me subjektin tregtar furnizues " \*\*\*" qe te provohet fakti se ne magazinat e tyre nuk ka asnje mall te ketyre markave tregtare qe prokuria i pretendon te paligjshrn, por organi i akuzes eshte mjaftuar vetem me marrjen ne pyetje te perfaquesuesve te kesaj shogerie tregtare te cilet norrnalisht nuk pritej te ndodhte ndryshe e kane mohuar. Atehere si eshte e mundur qe versioni i deklaruar nga subjekti " \*\*\*" ka qene i besueshem ku nderkohe nuk eshte ushtruar asnje kontroll nga ana e Prokurorise prane magazinave te saj per te hetuar per kete fakt (sic eshte bere ne rastin konkret) por ngarkon te pandehurin me perjegjesi penale.

Por meqenese pretendohet nga subjekti tregtar " \*\*\*" se ajo nuk i ka shitur mallrat e markave te lartpermendura pse nuk u hetua se cfare mallrash dhe cfare marke i ka shitur te pandehurit? Pasi ne faturat tatile te leshuara nga ky subjekt nuk percaktohet as marka dhe as logo e mallrave por thjesht citohet lloji, sasia dhe cmimi, fatura keto te administruara gjate hetimit te kesaj ceshjtje, qe ndodhen ne fashikullin hetimor.

Prokuroria e ka mbeshtetur akuzen ne faktin e gjetjes se ketyre mallrave ne dyqanin e te pandehurit, edhe pse ai disponon faturat tatile per te gjithe mallin qe gjendet ne dyqanin e tij. Por organi i akuzes pa kryer veprime te tjera hetimore ku te kontrollonte magazinat ku ky subjekt furnizohej dhe te verifikonte nese gjendej mall me marka te tilla, asaj i eshte dukur me bindese te akuzonte te pandehurin, veteri sepse ne faturat tatile nuk kishte percaktim te emrit te markave.

I pandehuri eshte furnizuar edhe nga subjekte te tjere si: \*\*\* Shpk. \*\*\* Shpk, \*\*\* Shpk, \*\*\* Shpk. \*\*\* Shpk. \*\*\*, ku keto subjekte operojne me firmat e

Iartpermendura, por me te gjitha keto subjekte tregtare ku une kam blere mallrat e ndryshem jane leshuar fatura tatimore konform ligjit, por pa specifikuar marken. Edhe ne furnizimet qe kane here ne shtetin Italian per mallrat e ndryshme, ka disponuar fatura tatimore ku jane dekluar edhe ne dogane por pa u specifikuar marka apo logo e tyre, thjeshte lloji i produktit, sasia dhc cmimi. (Fatura tatimore italiane te depozituara ne fashikullin e hetimit).

Nga ana e organit te akuzes pretendohet se ne rastin konkret jane shkelur norma te parashikuara ne Nenet 140, 141, 142, 156, te Ligjit Nr. 994 7 date 07.07.2008 " Per Pronesine Industriale", dispozita keto qe nuk gjejne zbatim ne rastin objekt gjykimi. Te gjitha keto nene dhe baza ligjore per te mbeshtetur fajesine, nuk kane te bejne me faktin objekt gjykimi.

Duke ju referuar Nenit 4 te Kodit te Procedures Penale i cili citon se: ... C'do dyshim per akuzen cmohet ne favor te te pandehurit"

Nese I referohemi Ligjit Nr. 9947 date 07.07.2008 "Per Pronesine Industriale" konkretisht Neni 36 percakton: 1-- Kur nje patente ka te beje me nje produkt, pronari i patentes ka te drejten eksklurive te ndaloje palet e treta te kryejne, pa autorizimin e tij, berjen, perdorimin, ofrimin per shitje, shitjen ose importimin per keto qellime te produktit.

2-- Kur nje patente ka te beje me nje proces, pronari i patentes ka te drejten ekskluzive te ndaloje palet e treta te kryejne, pa autorizimin e tij, veprimet qe vijojne: a) te perdore procesin, qe perben objektin e patentes; b) te perdore, te ofroje per shitje, te shese ose te importoje, per keto qellime, te pakten produktin, qe perfitohet drejtperdrejt nga ky proces.

3-- Pronari i patentes ka te drejte te emeroje dhe t'ua transferoje patenten zevendesuesve te tij ligjore, si dhe te lidhi kontrata licencimi per patenten.

Pra, sic percakton kjo dispozite, qe te kemi veper penale kerkon qe subjekti i vepres penale te jete ne dijeni se produkti, malli apo sherbimi qe ofron per shitje jo vetem qe eshte e tille qe mbrobet nga nje patente, dizenjo industriale apo marke tregtare sikurse ne rastin konkret, por gjithashtu te kete dijeni se nuk eshte dhene pelqimi nga pronari per shitjen e tyre. Ne rastin konkret ne shqyrtim, nuk provohet qe i pandehuri \*\*\* te kete dijeni se importimi i ketyre mallrave nga firma tregtuese ( qe kane leshuar fatura tatimore) qe tashme i shet ne dyqanin e tij, eshte bere ose jo pa pelqimin e pronarit te tyre.

Kjo pasi, sic provohet , keto mallra jane te blera ne nje shoqeri tregtare qe operon ne tregun shqiptar me shumice. Pra sic provohet , I pandehuri eshte person fizik qe ushtron tregtim me pakice dhe malli qe tregton eshte blere kundrejt faturave perkatese tatimore tek nje person juridik qe ushtron aktitivitet tregtar te licensuar.

Per te gjitha sa cituam dhe arsyetuam me siper, bazuar edhe ne Nenin 388 germa "b" te Kodit te Procedures Penale, gjykata konkludoi ne pafajesine e te pandehurit \*\*\*, pasi fakti objekt gjykimi nuk perben veper penale si dhe Heqjen e sekuestros te sendeve te sekuestruara sipas procesverbaleve te date 07.10.2015. mbajtur nga oficeri i Policise Gjyqesore \*\*\* dhe \*\*\*.

Gjithashtu, gjykata veren se Neni 393/1,2 te K.Pr.Penale, percakton menyren e disponimit te gjykates mbi "shpenzimet procedurale", duke nenkuptuar teresine e shpenzimeve te parapaguara nga shteti gjate gjithe procedimit penal, qe nga hetimet paraprake deri ne dhenien e vendimit nga gjykata. Si rrjedhim, gjykata ne kete vendim perfundimtar, bazuar ne Nenin 485/3 te K.Pr.Penale, i ngarkon te gjitha shpenzimet procedurale organit te akuzes.

#### **PER KETO ARSYE**

**Gjykata bazuar në Nenet 149/a/c të Kodit Penal dhe Nenet 379, 388 germa "b", 406/1 dhe 485 të Kodit të Procedurës Penale,**

#### **V E N D O S I**

--Deklarimin e pafajshem të të pandehurit \*\*\*, për kryerjen e veprës penale "Shkelja e te drejtave te pronesise industriale", parashikuar nga Neni 149/a-c i K.Penal.

--Ne referim te Nenit 190/ç te K.Pr.Penale, provat materiale te sekuestrua sipas dy procesverbaleve per sekuestrimin e provës materiale, date 07.10.2015, t'i kalojne pronarit te ligjshëm.

--Shpenzimet proceduriale hetimore dhe gjyqesore i ngarkohen Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

--Kundër ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane brenda 10 diteve, duke filluar ky afat nga dita e neserme e shpalljes se vendimit.

--U shpall në Tiranë, më datë 11.07.2016.

**SEKRETARE  
GJYQTARE  
MARJANA XHAMALLATI  
KLORINDA ÇELA**